



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor  
Nr: 04-351/02-45196  
Dt. 22.04.2026  
P r i z r e n

**DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR**, me kërkesë së **Nazmi, Urim dhe Nuri Gashi** nga Prizreni, me të cilën pala ka kërkuar leje për: **Ndërtim të objektit afarist**, në bazë të neneve 3alineja 1 pikat 1.1,1.4,1.7 ,1.10,1.16, 1.17,1.20,1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2 ,e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.1 si dhe nenit 14.alineja 1 pika 1.1 si dhe ne lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110,dhe në harmoni me dispozitat e nenit 3 alineal pikat 1.1,1.3,1.5,1.6,1.7,dhe 1.8 e lidhur me nenet 4,5, dhe 9 dhe 11të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr.01/011—6604 të dt.18.12.2008 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13,14,27,44,45,46,47,124 e në lidhje me nenin 125 LPA-së nr. 05/L-031, si dhe konform nenit 33 pika 13, dhe konform nenit 23 dhe 27 pika 6.1, e Rregullores për taksa Komunale nr.001/011-99275 dt.30.06.2022 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, merr kete:

**VENDIM**  
(për Leje Ndërtimore)

|                                 |  |         |    |
|---------------------------------|--|---------|----|
| Kjo Leje ndërtimore i lëshohet: |  |         |    |
| Emri:                           | <b><u>Nazmi ,Urim dhe Nuri Gashi</u></b> |         |    |
| Adresa:                         | <b>„Sheshi Shadervan , nr.8.”</b>        |         |    |
| Telefoni:                       | //                                       | Emaili: | // |

|                     |                              |         |    |
|---------------------|------------------------------|---------|----|
| Emri i projektit    | <b>Objekti – afarist</b>     |         |    |
| Emri i projektuesit | “DIARKO”SHPK                 |         |    |
| Adresa:             | “Qazim Berisha”,H3/1-Prizren |         |    |
| Telefoni:           | 044//                        | Emaili: | // |

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Nazmi, Urim dhe Nuri Gashi** nga Prizreni, me adrese në **Rr.,//”, nr.//.** ne Prizren me të cilën pala ka kërkuar leje per: **Ndertim te objektit afarist** me etazhitet **B+P+1** në ngastrën katastrale numër **P-71813068-03388-1 Z.K.Prizren.**

|                      |  |                  |
|----------------------|--|------------------|
|                      | Për punët ndërtimore në vijim  |                  |
| Adresa:              | <b>„Sheshi Shadervan”, nr.8.- Prizren</b>  |                  |
| Zonat (t) Kadastrale | <p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar zone e banimi:banim i përhershëm, etj</p> <p>Objekti – <b>afarist</b> do të ndërtohet në parcelën <b>P-71813068-03388-1 Z.K.Prizren</b> me sip.111m<sup>2</sup></p> <p>Etazhiteti i objektit do të jetë B+P+1</p> <p>Sipërfaqja bruto e bodrumit është S=88.80m<sup>2</sup>.</p> <p>Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=88.80m<sup>2</sup>.</p> <p>Sipërfaqja bruto e katit I është S=88.80m<sup>2</sup>.</p> <p>Sipërfaqja bruto e objektit është S=266.4m<sup>2</sup>(sipas lejes, pagese)</p> <p>Sipërfaqja neto e objektit është S=214.4m<sup>2</sup>.</p> <p>Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 1116.22€.</p> <p>Vlera e objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 123,285.70€</p> | GPS Koordinatat: |

|  |
|--|
| Lloji i ndërtimit të propozuar:<br>Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/> Rindertim <input type="checkbox"/> Ripatim <input type="checkbox"/> |
| Kategoria e ndertimeve te propozuera:<br>Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/> Kategoria II <input type="checkbox"/>                           |
| A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>   |
| Perdorimi i propozuar i objektit- afarist  |



Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Nazmi, Urim dhe Nuri Gashi** nga Prizreni, me adresë në **Rr.,//”, nr.//** ne Prizren me të cilën pala ka kërkuar leje për: **Ndërtim të objektit afarist** me etazhitet **B+P+1** në ngastrën katastrale numër **P-71813068-03388-1 Z.K.Prizren**.

**Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
  - Informata mbi Lejen Ndërtimore
  - Informatat mbi projektuesin
  - Informata mbi kontraktuesin
  - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
  - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
  - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
  - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
  - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriatit i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
  - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga koprojektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të



gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:

- Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
  - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
  - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

### A r s y e t i m

Aplikuesi **Nazmi, Urim dhe Nuri Gashi** nga Prizreni ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërmore për **objektin – afarist**.  
Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërmore bazohet në shqyrtimin e provave:


- Njoftim për plotësim të dokumentacionit.
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Vertetim nga sektori i menaxhimit të mbeturinave nga DSHP.
- Vendimi i MKRS-Qendra rajonale për Trashegimi Prizren me nr.04/4 të dt,19.06.2025 dhe rekomandimi nga KTKPQHP të dt.12.06.2025 nr.44/2025.
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike – për Kategorinë e I

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

#### DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR


Nr.04-351/02-45196

**Bashkepunetor profesional:**

  
Zana Belloda inxh.dip.ark.



**DREJTORI:**

  
Florent Ukaj ecc.dip.

